

V E N D I M
Nr.319, datë 5.8.1997

PËR CAKTIMIN E KËSHILLIT TË MBROJTES SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Presidentit të Republikës, i Rexhep Meidani, me cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Mbrojtjes

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Në përbërje të Këshillit të Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë caktohen:

1. Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor.
2. Kryetari i Këshillit të Ministrave.
3. Ministri i Mbrojtjes.
4. Ministri i Punëve të Jashtme.
5. Ministri i Brendshëm.
6. Ministri i Financave.
7. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.
8. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
9. Kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar.
10. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

II. Vendimi nr.214, datë 11.12.1991 shfuqizohet.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.